



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:110212

Datë: 26.09.2019

Numri i dokumentit: 00536020

P.nr.112/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të akuzuarit A.I nga ..., për shkak të veprave penale: I. Kanosje, të parashikuar nga neni 185 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), dhe, II. Hyrja në sistemet kompjuterike, të parashikuar nga neni 339 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4604//2018, datë 30.01.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë me datë 13.09.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ibrahim Fejza, të akuzuarit A.I. dhe të dëmtuares M.F, në po të njejtën ditë e shpalli publikisht, ndërsa me datë 26.09.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.I, nga i ati M., dhe e ëma B., e vajzërisë D., i lindur me datë ..., në ..., me vendbanim në Rr.”...” në lagjen ... - ..., i pa martuar, punon si shankist, ka të përfunduare shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ..., shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

I

Sepse,

Me datë 03.06.2018, në orët e mbrëmjes i akuzuari A.I seriozisht e ka kanosur ish të dashurën e tij - të dëmtuarën M.F, ashtu që përmes telefonit me anë të një mesazhi dërguar nga telefoni i vëllait të tij ..., e ka kërcënuar të dëmtuarën me fjalët “unë po të betohem në varrin e babës dhe varr të motrave të mija që kam me të grabitë, se qetash ja ka qit kapakun”, me ç ‘rast ka shkaktuar frikë dhe ankth tek e dëmtuara për jetën e saj.

Me këtë ka kryere veprën penale: Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së.

II

Sepse,

Në të njejtën ditë, kohë dhe vend si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i akuzuari A.I paautorizim, në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim që ti shkaktoj dëm personit tjetër, ka publikuar fotot e të dëmtuarës M.F, ashtu që ka hapë një adresë në rrjetin social “Instagram” në emër të dëmtuarës duke përdorur emrin dhe fotografinë e saj ku kanë dalë së bashku me të.

Me këtë ka kryer veprën penale: Hyrje në sistemet kompjuterik nga neni 339 par.1 të KPRK.

Andaj, Gjykatat në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 49, 51, 52, 73, 185 dhe 374 të KPRK-se, dhe nenit 365, 450,460, 463 të KPP-se, e;

GJYKON

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro.

Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit me dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale në afat prej 1 viti, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 250 euro.

Gjykata në bazë të nenit 80 të KPRK-së, të akzuarit, i:

SHQIPTON

- I. DËNIM UNIK me BURGIM të kuzhtëzuar në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. DËNIM UNIK me GJOBË në shumën prej 650 (gjashtëqind e pesëdhjet) euro, i cili dënim është i obliguar ta paguajnë në afat prej tre (3) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në tre këste të barabarta, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtuqë dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg.
- III. Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 40€, ndërsa në emër të Fondit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- IV. Pala e dëmtuar, M.F., me adresë: Rr. "... " për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.4604/2018 të datës 30.01.2019, kundër të akzuarit A.I. nga ... për shkak të veprës penale: Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së dhe vepres penale: Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë me datë 13.09.2019 ashtu që në këtë seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës.

Në lidhje me pranimin e fajësisë prokurori i shtetit ka deklaruar se konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit, ky pranim i fajësisë bazohet edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa këtë pranim të fajësisë Gjykata të merr si rrethanë lehtësuese për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pastaj pendimin e

thell të të akuzuarit, premtimin e tij që nuk do të përserisë vepra të njëjta, gjendjen e tij ekonomike-sociale i cili punon me pagë të ulët, është mbajtes i familjes.

E dëmtuara M.F ne lidhje me pranimin e fajësisë të të akuzuarit ka deklaruar se nuk dëshiroj që të komentoj faktin nëse Gjykata e pranon apo jo fajësinë e të akuzuarit mirëpo është faktë se edhe më herët më ka premtuar mua që nuk do të më shqetësoj më, frikësohem se nuk do ta mbajë këtë premtim.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i akuzuari, në mbështetje të nenit 248 e lidhur me nenin 326 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti policor me numër te rastit ... i datës 03.06.2018; Deklarata e të akuzuarit A.I e dhënë në polici e datës 03.06.2018 dhe 06.06.2018; Deklarata e të dëmtuares M.F e dhënë në polici e dates 03.06.2018 dhe 04.06.2018; Mesazhet e shkruara. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit te fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo mund të bëjë ankesë sa i përket lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se mbetëm në tërsi pranë akuzës kundër të akuzuarit A.I për veprat penale si në aktakuzë, dhe i propozoj Gjykates qe ndaj tij të shqiptoj denimin e bazuar ne ligj.

E dëmtuara M.F në fjalën përfundimtare ka deklaruar se qëndroj mbrapa atyre që thash më lartë, edhe njëher dua t'ia perseri Gjykates që rasti që me ka ndodhur mua më ka shqetësuar shumë andaj i propozoj Gjykatës që të merr vendim të merituar.

I akuzuari A.I në fjalën përfundimtare ka deklaruar : unë qëndroj mbrapa atyre që thash më lartë, qellimi im është që të mbyllet kjo punë, edhe njëherë premtoj që nuk do ti përseris këto veprime ndërsa se sjelljet e mija do të jenë korrekte.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka kryer veprat penale: I.Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-së, e për të cilan vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet, si dhe veprën penale: II. Hyrja në sistemet kompjuterike nga neni 339 par.1 të KPRK-së, për të cilën vepër është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale, gjë që nga provat rezulton se i akuzuari këtë vepër e kishte kryer me dashje, mënyrëmn dhe rrethanat në të cilat është kryer,

që nga provat rezulton këmbngulësia e të pandehurit për të arritur qëllimi qoftë përmes mesazheve kërcënuese apo edhe përdorimi i fotografisë së të dëmtuarës.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar thellesisht për ndodhjen e rastit, faktin se i premtun Gjykatës që nuk do të perseris me sjellje të tilla, sjellja korrekte e të akuzuarit, rrethanat personale pasi që është mbajtës i familjes dhe jeton nga paga e shankistit, çka për gjykatën rezulton me kushtet e vështira ekonomike, si dhe moshën e tij relativisht të re, që në rastin konkret mund të bie më lehtë nën ndikimin shoqëror.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg me kusht ndaj të akuzuarit dhe dënimi me gjobë është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i akuzuari të mos përsërisë veprime të tilla dhe do ndikojë në ngritjen e vetëdijes se askujt nuk i lejohet cënimi i integritetit dhe privatësisë së tjetrit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463 të KPP-së, pasi që e dëmtuara nuk ka paraqitur vlerë të saktë të dëmit të pretenduar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.112/2019, datës 26.09.2019
2019:110212, 26.09.2019

Procesmbajtësja
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.